

Raporti vjetor

Ne Aka

Rrugëtimi deri më tani

Prill 2026



Prezantuar për : Junior Achievement of Albania

Prezantuar nga : Kompania e nxënësve “Ne Aka”

Mësuese : Orilda Kalami

Mentore : Edlira Mali

Shkolla 12-vjeçare jopublike “TES” Tiranë



Pasqyra e lëndës

Përshkrimi i kompanisë | Vizioni & Misioni **3**

Struktura e kompanisë **4**

Analiza e kompanisë **5**

Prodhimi i produktit \ shërbimit **6**

Shitjet & Marketingu **7**

Takime dhe aktivitete **7.1**

Pasqyra financiare |
Analiza e konkurrentëve **8**

Përmbledhja e planit
të biznesit **9**



Përshkrimi i kompanisë

Kompania “Ne Aka” është një biznes social me mision të fuqishëm për përfshirje dhe barazi, i cili u jep mundësinë fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara të jenë krijues aktivë në shoqëri dhe të promovojnë talentin e tyre unik. E udhëhequr nga përkushtimi dhe dëshira për të ndërtuar një komunitet gjithëpërfshirës, “Ne Aka” operon në një hapësirë virtuale ku prezantohen një larmishmëri produktesh të realizuara nga këta fëmijë dhe të rinj me dhunti të veçanta. Përveç kësaj, kompania organizon aktivitete artistike dhe krijuese që synojnë të përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë, duke ndërtuar një hapësirë integruese ku ata ndihen të vlerësuar, të barabartë dhe të frymëzuar për të zhvilluar potencialin e tyre. Nëpërmjet këtyre nismave, “Ne Aka” krijon mundësi të barabarta dhe mbështet rritjen personale e sociale të fëmijëve e të rinjve, duke i ndihmuar të shprehin veten dhe të kontribuojnë në shoqëri me besueshmëri dhe barazi.

Vizioni

“Ne Aka” synon që të përfaqësojë një model frymëzues biznesi social në Shqipëri e më gjerë, ku fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara shihen jo për kufizimet e tyre, por për talentin, kreativitetin dhe potencialin unik që mbartin. Vizionin tonë e ndërtojmë mbi një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku fëmijët dhe të rinjtë ka hapësirën dhe mundësinë të shprehet, të krijojë dhe të kontribuojë në mënyrë të barabartë. Në të ardhmen, “Ne Aka” ka si objektiv që të zgjerohet si një platformë e qëndrueshme që fuqizon fëmijët e të rinjtë, ndërton ura mes artit, shoqërisë dhe barazisë, dhe nxit një kulturë respekti, pranimit dhe vlerësimi të diversitetit.

Misioni

Misioni i “Ne Aka” është të punojë çdo ditë për të krijuar dhe forcuar një hapësirë gjithëpërfshirëse ku fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara ndihen të pranuar, të barabartë dhe të vlerësuar për talentin e tyre. Përmes zhvillimit të vazhdueshëm të platformës sonë virtuale, organizimit të aktiviteteve artistike dhe mbështetjes së vazhdueshme kreative, ne angazhohemi të ofrojmë mundësi reale për shprehje, zhvillim personal dhe pjesëmarrje aktive në shoqëri. Çdo veprim i “Ne Aka” udhëhiqet nga përkushtimi për të ndërtuar besim, për të nxitur vetëbesimin fëmijëve dhe të rinjve dhe për të kthyer kreativitetin e tyre në një forcë që promovon barazi, dinjitet dhe përfshirje sociale në mënyrë të qëndrueshme.

Vizioni i “Ne Aka” për të ardhmen në afat të mesëm është të konsolidohet si një platformë e qëndrueshme dhe e njohur në Shqipëri, duke zgjeruar gamën e produkteve dhe aktiviteteve artistike, si dhe duke ndërtuar partneritete të forta me shkolla, organizata dhe biznese që mbështesin përfshirjen sociale. Në këtë fazë, synohet rritja e ndikimit në komunitet dhe krijimi i më shumë hapësirave ku fëmijët me aftësi të kufizuara mund të shprehin talentin e tyre.

Ndërsa në afat të gjatë, “Ne Aka” aspiron të shndërrohet në një model referues ndërkombëtar i biznesit social, duke zgjeruar aktivitetin përtej kufijve të Shqipërisë, duke zhvilluar programe të strukturuar edukative dhe artistike, si dhe duke ndikuar në ndryshimin e perceptimit shoqëror ndaj përfshirjes, barazisë dhe vlerësimit të diversitetit.


Struktura e kompanisë



Erda Çausi
Presidente



Erla Llagami
Drejtoresh e marrëdhënieve
me publikun



Shazie Zenelhasani
Drejtoresh e marketingut



Gloria Proko
Drejtoresh e prodhimit



Raisa Myftari
Drejtoresh e financës



Edlira Mali
Mentore



Orilda Kalami
Mësuese

Analiza e kompanisë

PROBLEMI

Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen ende me mungesë të hapësirave gjithëpërfshirëse ku mund të shprehin talentin e tyre, të zhvillojnë aftësi krijuese dhe të ndihen pjesë aktive e shoqërisë. Shpesh, mundësitë për përfshirje artistike, sociale dhe krijuese janë të kufizuara, duke i lënë këta fëmijë dhe të rinj në hije dhe pa vëmendjen që meritojnë.

Mungesa e platformave dhe aktiviteteve të dedikuara që promovojnë barazi dhe pranimin e diversitetit ndikon negativisht në vetëbesimin dhe zhvillimin personal të tyre. Në shumë raste, talenti i fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara mbetet i pazbuluar ose i pavlerësuar, ndërsa shoqëria humbet një potencial të rëndësishëm krijues.

Për këtë arsye, ekziston nevoja për iniciativa të vazhdueshme sociale që krijojnë hapësira të sigurta dhe integruese, ku fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të kenë mundësi reale për t'u shprehur, për t'u zhvilluar dhe për të kontribuar në shoqëri në mënyrë të barabartë dhe dinjitoze.

KLIENTI

- **Klienti:** B2C – Prindër dhe individë që mbështesin kauza sociale dhe blejnë produktet e “Ne Aka”.
- B2B – Shkolla, organizata dhe biznese që bashkëpunojnë ose mbështesin aktivitetet dhe produktet.
- **Konsumatori** – Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara që përfshihen e krijojnë, si dhe fëmijët e tjerë që përdorin produktet dhe shërbimet e “Ne Aka”.

Prindërit dhe shoqëria janë gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për përfshirjen dhe kërkojnë hapësira të sigurta ku fëmijët dhe të rinjtë të shprehin talentin dhe të ndihen të pranuar. Ndërkohë, bizneset dhe institucionet duan të mbështesin iniciativa me ndikim social.

Fëmijët dhe të rinjtë tërhiqen nga aktivitetet kreative dhe kanë nevojë për hapësira ku të shprehen lirshëm dhe të ndihen të vlerësuar.

Motivimi për të blerë

Klientët ndihen të motivuar të blejnë kur e dinë që produktet dhe aktivitetet e “Ne Aka” kanë një ndikim real social, duke mbështetur përfshirjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara. Ndërkohë, vetë fëmijët dhe të rinjtë përfshihen dhe ndihen të motivuar kur kanë mundësi të shprehin talentin e tyre në një mjedis kreativ dhe mbështetës.

Gatishmëria për të paguar

Bazuar në rritjen e ndërgjegjësimit për përfshirjen dhe kauzat sociale, klientët janë të gatshëm të paguajnë për produkte dhe aktivitete që kanë vlerë sociale dhe emocionale. Nëse ofrohet cilësi, autenticitet dhe një mision i qartë, “Ne Aka” perceptohet si një iniciativë me vlerë, ku blerja shihet si një kontribut në barazi dhe zhvillim shoqëror.

PRODUKTE / SHËRBIMI

Çfarë ofrojmë?

“Ne Aka” është një biznes social që fuqizon fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara duke u dhënë mundësinë të shprehin kreativitetin dhe talentin e tyre. Ne ofrojmë një hapësirë virtuale ku prezantohen dhe shiten produkte unike të krijuara nga këta fëmijë dhe të rinj, si dhe organizojmë aktivitete artistike dhe krijuese që nxisin përfshirjen dhe zhvillimin e tyre.

Përfitimet:

- Një hapësirë gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
- Zhvillim kreativ, emocional dhe social.
- Promovim i talentit dhe vetëbesimit.
- Mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe shprehje.
- Produkte unike me vlerë artistike dhe sociale.
- Ndërgjegjësim dhe përfshirje më e madhe në komunitet.

Dallimi nga konkurrenca

Ndryshe nga platformat e zakonshme të shitjes apo iniciativat sociale, “Ne Aka” ndërthur kreativitetin me përfshirjen sociale, duke vendosur në qendër fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Përmes aktiviteteve artistike dhe një hapësire të dedikuar, ne krijojmë një ambient ku çdo fëmijë dhe i ri ndihet i vlerësuar dhe i barabartë, duke nxitur zhvillimin e tyre në një mënyrë të sigurt, frymëzuese dhe gjithëpërfshirëse.

ZGJIDHJA

“Ne Aka” krijon një hapësirë të sigurt dhe gjithëpërfshirëse ku fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara zhvillojnë talentin e tyre përmes aktiviteteve artistike dhe produkteve kreative që prezantohen dhe shiten online.

Monetizimi realizohet përmes shitjes së produkteve dhe bashkëpunimeve me biznese apo organizata që mbështesin kauza sociale. Në të ardhmen, synohet realizimi i një game më të gjerë të produkteve dhe programeve artistike.

Si e përmireson jetën e klientit?

Fëmijët fitojnë vetëbesim dhe aftësi, ndërsa prindërit ndihen të sigurt për zhvillimin e tyre në një mjedis mbështetës dhe gjithëpërfshirës.

Prodhimi i produktit

Produktet e kompanisë "Ne Aka" janë konceptuar si mjete që promovojnë talentet e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përcjellin mesazhin e barazisë.

Çdo produkt është ndërtuar mbi idenë që këta fëmijë kanë aftësi dhe potencial artistik dhe se shoqëria duhet t'i njohë dhe t'i mbështesë. Procesi i prodhimit ka filluar nga identifikimi i nevojave dhe mënyrave më efektive për t'i bërë talentet e tyre të dukshme për shoqërinë.

Produktet e kompanisë "Ne Aka"

	<i>Website www.neaka.net</i>	<i>Libri për fëmijë "Mësuese Aka dhe..."</i>	<i>Çanta të personalizuar me vizatimet e të rinjve</i>	<i>Biletat e koncertit "Talentit nuk ka kufij".</i>
Përshkrimi	Website-i shërben si platforma kryesore për prezantimin e talenteve, produkteve dhe aktiviteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ai u jep mundësinë fëmijëve të shprehën përmes artit dhe krijimtarisë së tyre. Gjatë krijimit të tij u punua në strukturën, përmbajtjen dhe pamjen vizuale, duke synuar një platformë të thjeshtë, funksionale dhe të qartë për përdoruesit.	Ky libër është krijuar për fëmijët e moshës 8–10 vjeç dhe përmban një histori edukative që trajton temën e aftësive të kufizuara në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Përmes personazheve, ai përcjell mesazhin se edhe pse jemi të ndryshëm, jemi të barabartë. Libri u zhvillua duke u përshtatur për audiençën dhe me ndihmën e specialistëve.	Këto çanta përbajnë vizatime të realizuara nga të rinjtë e qendrës "Lumturo Dhimbjen", duke pasqyruar kreativitetin dhe mënyrën e tyre unike të të shprehurit. Përveç funksionit praktik, ato shërbejnë edhe si simbol i përfshirjes dhe mbështetjes ndaj kësaj kategorie.	Ky koncert u organizua nga kompania "Ne Aka" në datën 10/03/2026, për të promovuar talentet e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara. Biletat u shitën në shkollën "TES", nëpër Tiranë, si dhe jashtë sallës ku u zhvillua koncerti. I gjithë publiku që dëshironte të shijonte shfaqjen ishte i pajisur me biletë, duke mbështetur kështu këtë aktivitet dhe mesazhin e tij.
Hapat e prodhimit të produktit	<ol style="list-style-type: none">1. Përcaktimi i qëllimit të platformës2. Planifikimi i strukturës dhe seksioneve kryesore3. Mbledhja dhe përgatitja e përmbajtjes4. Krijimi i dizajnit vizual5. Zhvillimi i teknik i faqes6. Testimi i funksionalitetit7. Publikimi për përdoruesit	<ol style="list-style-type: none">1. Përcaktimi i mesazhit kryesor2. Krijimi i historisë3. Përshtatja për moshën përkatëse4. Ilustrimi i përmbajtjes5. Dizajni i faqeve6. Përgatitja për botim	<ol style="list-style-type: none">1. Përcaktimi i idesë së produktit2. Përzgjedhja e vizatimeve3. Zgjedhja e modeleve të çantave4. Përgatitja për stampim5. Realizimi i stampimit6. Finalizimi i produktit	<ol style="list-style-type: none">1. Dizajni i modelit2. Vendosja e informacionit kryesor3. Shtimi i elementeve grafike4. Printimi5. Shpërndarja dhe shitja

Çdo hap i prodhimit është realizuar me bashkëpunim në grup midis anëtarëve të kompanisë, duke kaluar nga ideimi, planifikimi, dizajni, krijimi i përmbajtjes dhe deri te prezantimi final i produkteve. Qëllimi ynë ka qenë që përmes këtyre produkteve të rrisim ndërgjegjësimin dhe të krijojmë një ndikim pozitiv në shoqëri. Për këtë arsye kemi bashkëpunuar me ekspertë dhe kompani të tjera sipas produkteve specifike, të cilet kanë ndihmuar për realizimin sa më të mirë të produkteve tona.

	<i>Çorapet shumëngjyrëshe të qendrës "Down Syndrome Albania"</i>	<i>Punimet prej argjile të Institutit të Nxënësve që nuk Dëgjojnë.</i>	<i>Dokumentari "Një botë, shumë ngjyra"</i>	<i>Revista "Ne Aka" (produkt në proces)</i>
Përshkrimi	Në bashkëpunim me qendrën "Down Syndrome Albania", jemi angazhuar në shitjen e çorapeve në ambientet e shkollës. Ky aktivitet ka pasur si qëllim promovimin e solidaritetit, rritjen e ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e iniciativave që lidhen me fëmijët me sindromën Down.	Në bashkëpunim me Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë, u organizua shitja e punimeve prej argjile të realizuara nga nxënësit. Këto punime pasqyrojnë kreativitetin dhe aftësitë e tyre artistike.	Dokumentari "Një botë, shumë ngjyra" Ky dokumentar pasqyron jetën, sfidat dhe talentet e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes intervistave dhe pamjeve reale. Ai synon të ndryshojë perceptimin e shoqërisë dhe të rrisë ndërgjegjësimin për përfshirjen sociale.	Revista është një produkt informues dhe kreativ që përmbledh aktivitetet, bashkëpunimet dhe ndikimin e projektit. Ajo ofron materiale edukative dhe praktike për komunitetin, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimin.
Hapat e prodhimit të produktit	Marrë nga Qendra e Shërbimeve - Down Syndrome Albania	Marrë nga Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë.	<ol style="list-style-type: none">1. Hartimi i idesë dhe strukturës2. Përgatitja e narracionit3. Planifikimi i xhirimeve4. Realizimi i filmimeve5. Montazhi i materialeve6. Editimi përfundimtar7. Publikimi dhe shpërndarja	<ol style="list-style-type: none">1. Përcaktimi i konceptit vizual dhe strukturës2. Mbledhja e intervistave3. Analiza e stereotipeve4. Përgatitja e materialeve ndihmëse5. Përfshirja e aspekteve ligjore dhe sociale6. Mbledhja e të dhënave statistikore7. Prezantimi i punimeve artistike8. Përfshirja e mesazheve sensibilizuese9. Informacion mbi sindroma dhe tema edukative.

Shitjet & Marketingu


Promovimi dhe njohja

-Është ndërtuar një identitet i qëndrueshëm dhe i dallueshëm i markës “Ne Aka” në rrjetet sociale (Instagram, Facebook, TikTok, YouTube), përmes publikimeve vizualisht tërheqëse, edukative dhe ndërgjegjësuere. Përmbajtja është e fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi përfshirjen sociale dhe fuqizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes artit.

-Është siguruar prezencë aktive në panaire, evente dhe aktivitete edukative, ku është mundur ndërveprimi i drejtpërdrejtë i fëmijëve me artin dhe publikun, duke kontribuar në krijimin e eksperiencave gjithëpërfshirëse dhe sensibilizuese.

-Janë realizuar dalje në emisione televizive dhe radiofonike, si dhe është zhvilluar promovim përmes bashkëpunimeve me profesionistë të fushës së edukimit dhe terapistë që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, është përfituar promovim nga personalitete të njohura, duke rritur shtrirjen dhe besueshmërinë e markës.

-Në komunikimin publik është përdorur personazhi “Aka”, së bashku me elemente të lidhura me identitetin, përfshirë figurat nga materiali edukativ “Mësuese Aka”, si dhe produkte konkrete si kartolina të realizuara nga fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Këto elemente kanë shërbyer si mjete efektive për komunikim dhe ndërgjegjësim publik.

 Website: neaka.net

 Instagram:

https://www.instagram.com/aka_kompania_jaa?igsh=OXZjMmcw eXZvcHZj

 Facebook:

<https://www.facebook.com/share/1FUccmfWj6/>

 Email: aka.jaa2026@gmail.com

 TikTok:

https://www.tiktok.com/@kompania_aka?_r=1&_t=ZS-946kHlgu07U

Të dhëna të rëndësishme

Rrjetet sociale

Prania e markës “Ne Aka” në Instagram (@aka_kompania_jaa) ka shënuar rritje të qëndrueshme, duke ndërtuar një komunitet aktiv dhe ndërveprues me **453 ndjekës**.

Deri më tani janë realizuar 120 postime, të cilat kanë generuar një trend në rritje të ndërveprimeve, duke arritur deri në:

- 169 pëlqime (likes)
- 16 komente
- 51 shpërndarje (shares)

Këta tregues evidentojnë rritjen graduale të angazhimit dhe interesit të audiencës ndaj përmbajtjes së publikuar.

Klientët

Klientët e “Ne Aka” përbëhen nga individë dhe institucione të cilët vlerësojnë produktet me vlerë sociale dhe artistike dhe mbështesin iniciativa që promovojnë përfshirjen dhe ndërgjegjësimin.

Profili i klientëve përfshin kryesisht:

Audienca përfshin kryesisht:

- Grupmoshën 20–45 vjeç
- Individë të vendosur në zona urbane
- Një përqindje të konsiderueshme të prindërve të rinj dhe profesionistëve të fushës së edukimit, psikologjisë dhe shëndetit
- Organizata dhe institucione që operojnë në fushën e përfshirjes sociale

Këta klientë karakterizohen nga një stil jetese aktiv, pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe sociale, si dhe interes për artin, kreativitetin dhe kauzat sociale.

Angazhimi i tyre realizohet përmes:

- Blerjeve në aktivitete dhe panaire
- Porosive online përmes rrjeteve sociale dhe platformës neaka.net
- Aktivitetit të lartë në rrjetet sociale, veçanërisht në Instagram dhe TikTok
- Ndërveprimit me përmbajtje edukative, emocionale dhe vizuale
- Interesit për histori frymëzuese dhe iniciativa me ndikim social

Bashkëpunime me organizata si “Lumturo Dhimbjen” dhe “Down Syndrome Albania”, përmes të cilave është mundur zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta, promovimi i produkteve me vlerë sociale dhe rritja e ndërgjegjësimit publik mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara

Podcast “Ne Aka”

Podcasti është zhvilluar si një mjet shtesë komunikimi dhe ndërgjegjësimi, me qëllim zgjerimin e ndikimit të “Ne Aka” dhe krijimin e një hapësire diskutimi mbi temat e përfshirjes sociale, edukimit dhe artit.

Qëllimi i tij është:

- Të trajtojë çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen
- Të promovojë histori frymëzuese dhe modele pozitive
- Të krijojë dialog ndërmjet profesionistëve dhe publikut

Në episodet e realizuara janë trajtuar tema të ndryshme, duke përfshirë:

- Rolin e artit në zhvillimin e fëmijëve
- Sfida dhe mundësi në përfshirjen sociale
- Eksperienca nga profesionistë të edukimit dhe terapistë.

Të ftuarit kanë përfshirë profesionistë të fushës, prindër dhe individë të angazhuar në kauza sociale



Titulli	Përshkrimi	Data	Statusi
Emisioni "Mirëmëngjes Shqipëri", RTSH	Presidentja e kompanisë sonë paraqet idenë /projektin që ka për qëllim krijimin e një hapësirë gjithpërfshirëse për fëmijët me aftësi ndryshe dhe promovimin e talenteve të tyre.	6 prill 2026	Aktivitet i përfunduar
"Zgjuhu me MCN", MCN TV	Përfaqësuese të kompanisë sonë ndajnë projektet dhe aktivitetet e bëra dhe ato që po marrin jetë.	7 prill 2026	Aktivitet i përfunduar
Radio Wave	Një bisedë spontane, në të cilën ndajmë synimet tona për ndërgjegjësim në shoqëri dhe krijimin e një hapësirë gjithpërfshirëse për të rinjtë me aftësi ndryshe.	16 prill 2026	Aktivitet i planifikuar
Panairi "Beauty Fair Albania 2026"	Në një ndër panairët më të rëndësishme të inovacionit dhe bukurisë, do të promovojmë "Ne Aka" si një biznes që mundëson ndërgjegjësim social dhe një mjedis ku të rinjtë me aftësi ndryshe mund të zhvillojnë talentet e tyre.	8-9-10 maj 2026	Aktivitet i planifikuar
hije Shtëpie", TV Klan	Një mëngjes dinamik në „Shije Shtëpie“ ku do të ndajmë visionin tonë për një shoqëri më gjithpërfshirëse ndaj individëve me aftësi ndryshe.	15 maj 2026	Aktivitet i planifikuar

Takime dhe aktivitete

Titulli	Përshkrimi	Data	Statusi
Takim me mentoren Edlira Mali	I gjithë ekipi u njoh me modulën "Kompania e Nxënësve". Morëm në studim librin e lëndës, si dhe diskutuam qëllimin e këtij moduli, rëndësinë dhe përgjegjësinë që mbart. Ky takim shërbeu si një hap i rëndësishëm drejt përgatitjes sonë dhe zhvillimit të aftësive sipërmarrëse.	1 Tetor 2025	Aktivitet i përfunduar
Brainstorm	I gjithë stafi u mbledh për të ndarë idetë e biznesit me njëri-tjetrin, duke përcaktuar një plan të mirëfilltë. Ky bashkëbisedim intensiv u zhvillua në praninë e mësueses së lëndës dhe mentores, duke krijuar një atmosferë produktive që ndihmoi në qartësimin e ideve dhe hodhi bazat për zhvillimin e mëtejshëm të projektit.	15 Tetor 2025	Aktivitet i përfunduar
Ndarje e strukturës së kompanisë	Në këtë mbledhje u realizua kandidimi për drejtues departamentesh dhe u zgjodh presidenti i kompanisë. U bë ndarja e punonjësve sipas aftësive dhe interesave në departamentet përkatëse. Kjo strukturë ndihmoi në organizimin më efikas të punës.	30 Tetor 2025	Aktivitet i përfunduar
Takim me stafin zhvillues të modulit të biznesit	Ekipi zhvilloi një diskutim të gjerë mbi idenë e biznesit, qëllimin kryesor, audiencën e synuar dhe mënyrat e financimit. U analizuan gjithashtu elementet kyç që e bëjnë një biznes të qëndrueshëm dhe konkurrues në treg. Ky takim shërbeu si një bazë për ndërtimin e identitetit të kompanisë.	15 Nëntor 2025	Aktivitet i përfunduar
Festë e Pavarësisë së Shqipërisë	Departamenti i prodhimit i "Ne Akës" përgatiti fjongo me ngjyrat e flamurit shqiptar, të cilat u shiten gjatë aktivitetit në shkollë. Kjo iniciativë synon të rrisë ndjenjën e patriotizmit dhe të përfshijë nxënësit në festime.	25 Nëntor 2025	Aktivitet i përfunduar
Takim me psikologun Flavia Shehu	Në këtë takim, "Ne Aka" u konsultua me psikologun e "Down Syndrome Albania", duke diskutuar vështirësitë që lidhen me sindromën Down dhe rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe mbështetjes për individët dhe familjet e tyre.	2 Dhjetor 2025	Aktivitet i përfunduar
Trajnim "Design Thinking"	Drejtoresha e financës dhe ajo e marketingut morën pjesë në trajnimin "Design Thinking" të JAA. Ato u frymëzuan me ide inovative dhe kuptuan rëndësinë e vendosjes së klientit në qendër të çdo vendimmarrjeje. Ky trajnim ndikoi pozitivisht në mënyrën e të menduarit dhe planifikimit të projekteve.	18 Dhjetor 2025	Aktivitet i përfunduar
Takim me znj. Brixhida Muça	U zhvillua takimi i parë me drejtuesen e qendrës "Lumturo Dhimbjen", ku u hodhën bazat e një bashkëpunimi të qëndrueshëm. U diskutuan ide konkrete për aktivitete të përbashkëta dhe mënyra se si biznesi mund të kontribuojë në komunitet.	6 Janar 2026	Aktivitet i përfunduar
Takim me znj. Edlira Martiri	Takimi me ekspertin e sigurisë kibernetike ishte mjaft informues. U diskutuan mënyrat për të ndërtuar një platformë online të sigurt dhe të besueshme për klientët. Kjo ndihmoi ekipin të kuptojë rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave dhe besimit në tregtinë online.	20 Janar 2026	Aktivitet i përfunduar
Panairi ushqimor	"Ne Aka" organizoi një panair ushqimor ku anëtarët e ekipit prezantuan produkte të përgatitura vetë. Aktiviteti jo vetëm që ndihmoi në mbledhjen e fondeve, por gjithashtu forcoi bashkëpunimin dhe shpirtin e ekipit.	1 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar
Vizitë në qendrën "Lumturo Dhimbjen"	Përfaqësuesit e "Ne Akës" vizituan qendrën dhe u njohën nga afër me aktivitetet e saj. Ata patën mundësinë të ndërveprojnë me të rinjtë dhe të kuptojnë më mirë nevojat dhe sfidat e tyre. Kjo eksperiencë ndikoi në forcimin e ndjeshmërisë sociale të ekipit.	2 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar
Aktivitet në Pallatin e Kongreseve	"Ne Aka" mbështeti dhe promovoi qendrën "Lumturo Dhimbjen" në aktivitetin e organizuar në Pallatin e Kongreseve. U përcollën mesazhe të forta ndërgjegjësimi për përfshirjen dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrja në këtë event rriti dukshmërinë e kompanisë.	7 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar
Aktivitet i Shën Valentinit	Në shkollë u organizua një aktivitet festiv me kënd fotografik, mesazhe sekrete dhe shitje produktesh. Nxënësit u përfshinë, duke krijuar një atmosferë pozitive dhe argëtuese. Ky aktivitet kontribuoi si në rritjen e të ardhurave, ashtu edhe në promovimin e kompanisë.	14 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar
Festë e Pavarësisë së Kosovës	Me këtë rast, "Ne Aka" krijoi dhe shiti fjongo me ngjyrat e flamurit të Kosovës. Aktiviteti kishte një qëllim ndërgjegjësuës dhe simbolik, njëkohësisht shërbeu si një burim i mirë të ardhurash për kompaninë.	17 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar

Takim me kompaninë "MeDit"	Ekipi zhvilloi një takim frymëzues me kompaninë "MeDit", fituese e çmimit në fushën e marketingut. U ndanë eksperiencia dhe këshilla praktike për menaxhimin dhe zhvillimin e një biznesi. Ky takim rriti motivimin dhe ambicien e ekipit.	19 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar
Aktivitet artistik në qendrën "Lumturo Dhimbjen"	Ekipi organizoi një aktivitet artistik për të rinjtë e qendrës, duke i inkurajuar të shprehin kreativitetin e tyre. Pikturat dhe vizatimet krijuan një atmosferë të ngrohtë dhe frymëzuese. Ky aktivitet forcoi lidhjet mes ekipit dhe komunitetit.	25 Shkurt 2026	Aktivitet i përfunduar
Trajnim "Report Writing & Communication"	Presidentja, drejtoresha e financës dhe e prodhimit morën pjesë në një trajnim profesional të JAA. Ato përfituan njohuri të reja mbi mënyrën e raportimit dhe komunikimit në biznes. Këto aftësi janë thelbësore për prezantimin dhe menaxhimin e projekteve.	2 Mars 2026	Aktivitet i përfunduar
Podcast "Aka", Episodi i parë	U publikua episodi i parë i podcast-it "Ne Aka", ku u prezantua historia dhe misioni i kompanisë. Ky podcast shërbeu si një mjet komunikimi për të arritur një audiencë më të gjerë. Ai ndihmoi në rritjen e ndërgjegjësimit për kauzën e biznesit social.	8 Mars 2026	Aktivitet i përfunduar
Koncert "Talenti nuk ka kufij"	Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, "Ne Aka" organizoi një koncert artistik. Aktiviteti solli në skenë talente të ndryshme dhe promovoi mesazhin e barazisë dhe përfshirjes. Ishte një shfaqje emocionuese që u mirëprit nga publiku.	10 Mars 2026	Aktivitet i përfunduar
Aktivitet i Ditës së Verës	Ekipi i "Ne Akës" punoi në krijimin e veroreve, të cilat u shitën gjatë javës tek të gjithë nxënësit. Ky aktivitet solli një atmosferë festive në shkollë, duke përcjellë traditën dhe gëzimin e ardhjes së pranverës.	12 Mars 2026	Aktivitet i përfunduar
Takim me psikologun Sofiona Lakuriqi	Ky takim këshilloi me psikologun e shkollës ishte i vlefshëm për procesin krijues. Gjatë diskutimit, morëm udhëzime të detajuara mbi qasjen e duhur në shkrimin e një historie për fëmijë, duke u fokusuar te gjuha e përshtatshme dhe mesazhi edukativ. U theksuan gjithashtu aspektet ku duhet të tregohemi të kujdesshëm.	15 Mars 2026	Aktivitet i përfunduar
Fushatë me "Down Syndrome Albania"	"Ne Aka" u angazhua në shitjen e çorapeve shumëngjyrëshe për ndërgjegjësim. Kjo iniciativë simbolike synonte të promovonte diversitetin dhe pranimin në shoqëri. Kjo iniciativë ndikoi në komunitetin shkollor.	20 Mars 2026	Aktivitet i përfunduar
Aktivitet kopshtarie në qendrën "Lumturo Dhimbjen"	Ekipi u bashkua me të rinjtë e qendrës për një aktivitet praktik në natyrë. Ata mbollën fara dhe punuan tokën, duke mësuar rëndësinë e kujdesit për mjedisin. Veprimtaria kontribuoi në bashkëpunimin dhe krijoi momente të bukura ndërveprimi.	2 Prill 2026	Aktivitet i përfunduar
Podcast "Aka", Episodi i dytë	Në episodin e dytë u trajtuan eksperiencat që po ndikojnë në formimin profesional të nxënësve. Patëm nderin të kishim me ne mentoren Edlira Mali, Sindi Sulaj dhe Orilda Kalami. Prania e tyre e bëri këtë episod më frymëzues dhe të vlefshëm për të rinjtë. Ato ndanë histori, këshilla dhe perspektiva të ndryshme për dëgjuesit.	3 Prill 2026	Aktivitet i përfunduar
Promovim i librit "Mësuese Aka dhe..."	Libri i Akës u prezantua në bibliotekën e shkollës "TES" në një event të organizuar nga ekipi. Presidentja, Drejtoresha e marrëdhënieve me Publikun dhe vajzat e prodhimit folën për punën dhe mënyrën si u krijua libri. Në aktivitet morën pjesë edhe fëmijë që e kishin lexuar librin dhe një autore e re, të cilët ndanë mendimet dhe përvojat e tyre, duke e bërë takimin më të gjallë dhe të veçantë.	10 Prill 2026	Aktivitet i përfunduar
Podcast "Aka", Episodi i tretë	Me shumë kënaqësi pritëm znj. Emanuela Pepkola Zaimi në studio, e cila ndau me ne eksperiencën e saj si sipërmarrëse e një organizate sociale në Shqipëri. Biseda ishte frymëzuese dhe plot mesazhe të vlefshme për të rinjtë, duke theksuar rëndësinë e angazhimit dhe kontributit në komunitet.	12 Prill 2026	Aktivitet i përfunduar
Kuti Bamirësie	"Ne Aka" do të organizojë një aktivitet bamirësie duke vendosur një kuti në hyrje të shkollës "TES", ku ndihmat do të shkojnë për "Lumturo Dhimbjen". Kjo nismë synon të nxisë solidaritetin dhe kontributin në komunitet, duke treguar se çdo ndihmë, sado e vogël, ka vlerë.	13 Prill 2026	Aktivitet i planifikuar
Panair i produkteve të Institutit Kombëtar për Nxënësit që nuk Dëgjojnë	Fëmijët e institutit kanë krijuar vepra artistike plot kreativitet dhe ndjenjë, përmes të cilave shprehin botën e tyre të brendshme. Në këtë panair, "Ne Aka" synon t'i promovojë dhe t'i shesë këto punime, duke vlerësuar talentin e tyre dhe duke rritur ndërgjegjësimin e mbështetjen për ta.	15 Prill 2026	Aktivitet i planifikuar
Ndeshje futbollit	"Ne Aka" do të zhvillojë një ndeshje futbollit me djemtë e vitit të dytë të shkollës "TES", në bashkëpunim me "Lumturo Dhimbjen" dhe "Down Syndrome Albania". Aktiviteti synon të promovojë përfshirjen, barazinë dhe bashkëpunimin përmes sportit, duke krijuar një atmosferë pozitive dhe duke thyer paragjykimet mes të rinjve.	17 Prill 2026	Aktivitet i planifikuar
Ndeshje Volejbollit	Vajzat e "Ne Akës" do të përballen në një ndeshje miqësore volejbollit me fëmijët e Institutit Kombëtar për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë. Përtej garës, ndeshja do të shërbejë si një mundësi për të krijuar miqësi të reja. Sporti bëhet kështu një urë lidhëse që afron të gjithë pjesëmarrësit dhe përcjell vlera të rëndësishme sociale.	21 Prill 2026	Aktivitet i planifikuar
Aktivitet në Qendrën Multifunkionale të Vorës	Në këtë aktivitet, "Ne Aka" dhe fëmijët e Qendrës Multifunkionale Vorë do të kalojnë një ditë të mbushur me energji pozitive, përmes lojërave argëtuese dhe edukative si shahu, ping-pongu, gara dhe kuice. Aktiviteti synon të nxisë bashkëpunimin, kreativitetin dhe aftësitë sociale, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore.	24 Prill 2026	Aktivitet i planifikuar
Premierë e filmit dokumentar "Një botë, shumë ngjyra"	Premiera e filmit nga "Ne Aka", e realizuar në formën e një dokumentari, synon të ndërgjegjësojë shoqërinë duke sjellë një pasqyrim të ndjeshëm dhe të vërtetë të tematikës "Aftësi e kufizuar". Përmes historive dhe mesazheve të tij, dokumentari synon të nxisë empatinë, mirëkuptimin dhe reflektimin tek publiku. Kjo premierë do të prezantohet edhe në shkollat tjera, duke i dhënë mundësinë një audience më të gjerë ta ndjekë.	30 Prill 2026	Aktivitet i planifikuar

Pasqyra financiare

Pasqyra e veprimtarive (Fitim – Humbje)	
	(në lekë)
Të ardhurat	
Të ardhurat nga produktet	10 085
Të ardhurat nga shërbimet (koncerti)	44 500
Totali	54 585
Shpenzimet	
Tatimi për shitje	-
Materialet dhe produktet	15 034
Shpenzimet nga website-i	4 000
Shpenzime të tjera (transport)	2120
Rrogat, pagat dhe komisionet	25 750
Donacione	7681
Totali i shpenzimeve	54 585
Llogaritja e fitimit/ humbjes neto	0

*Nuk janë dhënë shpërblime të shoqërise

Pasqyra e gjendjes (Balanci)	
	Vlera (në lekë)
Aktivitet: gjendja në të holla	36 545
Detyrimet dhe kapitali:	
Tatimi për shitjet	0
Kapitali aksionar	24 000
Fitimi neto	0
Totali	24 000
Llogaritja e fitimit/ humbjes neto	0

*Vlera e fituar nga kapitali aksionar është përfshirë në donacione

Vlera kontabël e aksioneve	
Fitimi neto	0
Kapitali aksionar	24 000
Totali	24 000
Numri i aksioneve të shitura	120

*Vlera e fituar nga kapitali aksionar është përfshirë në donacione

Përcaktimi i çmimeve (në lekë)					
Produkti	Shpenzimet			Marzhi (20%)	Çmimi për njësi (në lekë) një njësi + marzhin
	Orët e punës	Materialet	Një njësi		
Libri (35 copë)	4750	9500	407	82	500
Letrat e fshehta (35 copë)	1050	1534	74	15	100
Kalendari (5 copë)	950	4000	990	198	1200
Çanta (10 copë)	1350	500	185	37	230

*Vlerat janë marrë me përafërsi

*Kategoria “Çmimi për njësi (në lekë) një njësi + marzhin” është rrumbullakosur në vlerën më të afërt

*Sipas marrëveshjes së arritur me shoqatat bashkëpunuese, fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i kompanisë është shpërndarë plotësisht në formën e donacioneve. Këto donacione janë dhënë për tre shoqata partnere: Qendra “Lumturo Dhimbjen”; Fondacioni “Down Syndrome Albania”; “Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë”. Si rezultat, kompania nuk ka mbajtur fitim të pashpërndarë, por e ka përdorur atë për qëllime bashkëpunimi.

Përmbledhja e planit të biznesit

Vizioni i shoqërisë:

Të bëhemi një platformë udhëheqëse sociale dhe kreative që promovon përfshirjen, barazinë dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Shqipëri dhe më gjerë, duke krijuar një hapësirë të sigurt dhe frymëzuese ku talenti i tyre vlerësohet, zhvillohet dhe kontribuon në një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse..

Misioni i shoqërisë:

Të ofrojmë mundësi reale për fëmijët me aftësi të kufizuara që të shprehin kreativitetin dhe talentin e tyre përmes produkteve artistike dhe aktiviteteve gjithëpërfshirëse, duke ndërtuar një komunitet që i mbështet, i fuqizon dhe i trajton me dinjitet e barazi. “Ne-Aka” synon të krijojë një hapësirë virtuale dhe fizike ku çdo fëmijë ndihet i vlerësuar, i përfshirë dhe i motivuar për të zhvilluar potencialin e tij dhe për të kontribuar aktivisht në shoqëri.

Rroga e punonjësit / Rroga e drejtuesve:

Shënim: Punonjësit nuk paguhen në takimin e parë pasi ky takim shërben për organizimin e shoqërisë.

Pagat e planifikuara:

Numri i punonjësve: 20

Rroga për punonjës: 50 lekë/Takim

Paga për drejtuesin: 200 lekë/Takim

-Paga e punonjësve për 15 takime: 11 250 lekë

- Paga e drejtuesve për 15 takime: 15 000 lekë

-Paga e presidentit: 2500 lekë

-Totali i pagave në 15 takime = 25 750 lekë

Tregu i synuar :

Fëmijë të moshës 6–9 vjeç dhe prindërit e tyre që kërkojnë libra edukative me mesazhe sociale dhe zhvilluese; shkollat dhe institucionet arsimore që synojnë të promovojnë gjithëpërfshirjen dhe ndërgjegjësimin. Libri, i krijuar nga kompania jonë, ka si qëllim t’u mësojë fëmijëve se të gjithë jemi të ndryshëm dhe të vlefshëm, duke i njohur ata se disa fëmijë kanë aftësi ndryshe.

Produkti:

Libër edukativ i ilustruar që përcjell mesazhe të thjeshta, informuese dhe të ndjeshme, i cili ndihmon fëmijët të kuptojnë se të gjithë jemi të ndryshëm dhe të barabartë. Përmes historisw dhe ilustrimeve tërheqëse, libri i mëson fëmijët rreth pranimit, respektit dhe ndërgjegjësimit për fëmijët me aftësi ndryshe, duke i edukuar në mënyrë të kuptueshme dhe pozitive.

Libri edukativ ofrohet me një çmim të përballueshëm, duke pasur parasysh qëllimin e tij social dhe edukativ. Çmimi i shitjes është i përshtatshëm për familjet dhe institucionet arsimore, duke mundësuar akses të gjerë për fëmijët. Në raste të veçanta, si bashkëpunimet me shkolla apo aktivitete sociale, libri mund të shpërndahet edhe në formën e donacioneve ose me çmime të reduktuara, në funksion të ndërgjegjësimit dhe përfshirjes sociale.

Çmimet e produkteve edukative të “Ne Aka”:

- Libri “Mësuese Aka dhe ...” – 500 ALL
- Letrat e fshehta – 100 ALL
- Kalendar – 1200 ALL
- Çanta – 230 ALL

Pika kritike :

- Shpërndarja dhe promovimi i librit në mënyrë efektive tek prindërit dhe institucionet arsimore (shkolla, kopshte, qendra për fëmijë).
- Ndërtimi i besimit te prindërit dhe mësuesit për përmbajtjen edukative dhe mesazhin e librit.
- Sigurimi i bashkëpunimeve me shkolla dhe organizata për të arritur një audiencë më të gjerë.

Objektivi i shitjes të produktit :

- Shitja e 100 kopjeve të librit brenda 3 muajve të parë.
- Arritja e një shpërndarjeje më të gjerë përmes bashkëpunimeve me librari dhe platforma online.
- Krijimi i partneriteteve me të paktën 5 shkolla apo institucione edukative gjatë vitit të parë

Planet e së ardhmes për “Ne Aka” :

1. Zgjerimi i produkteve dhe platformës

“Ne Aka” synon të vazhdojë zhvillimin e platformës virtuale duke shtuar produkte të reja artistike të krijuara nga fëmijët me aftësi të kufizuara, si punime artizanale, ilustrime, libra dhe produkte kreative me mesazh social. Platforma do të shërbejë gjithnjë e më shumë si një hapësirë për promovimin e talenteve, historive dhe krijimtarisë së tyre, duke rritur dukshmërinë dhe ndikimin në komunitet.

2. Zhvillimi i aktiviteteve artistike dhe edukative

Në të ardhmen, “Ne Aka” planifikon të organizojë më shumë punëtorë artistike, aktivitete krijuese dhe evente kulturore, ku fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të shprehin veten, të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre sociale dhe emocionale. Këto aktivitete do të realizohen në bashkëpunim me shkolla, qendra sociale dhe institucione kulturore.

3. Zgjerimi i bashkëpunimeve dhe partneriteteve

Një fokus i rëndësishëm do të jetë forcimi i bashkëpunimeve me organizata, qendra komunitare, biznese dhe institucione që mbështesin përfshirjen sociale. Këto partneritete do të ndihmojnë në krijimin e projekteve të reja dhe në rritjen e ndikimit të “Ne Aka” në nivel lokal dhe kombëtar.

4. Produkte të reja sensibilizuese dhe edukative

“Ne Aka” synon të zhvillojë produkte të reja edukative si libra, revista, materiale audiovizuale dhe dokumentarë që trajtojnë tema të përfshirjes, barazisë dhe aftësive të kufizuara. Këto produkte do të shërbejnë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndryshimin e perceptimit të shoqërisë ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Linku i videos përmbledhëse :

<https://youtu.be/5UKvFzoeyt4?si=rR2mbBBc9UZNRk9V>

STATUTI I SHOQËRISË

Në, të nënshkruarit anëtarë dhe vullnetarë, i drejtohem zyrës së Junior Achievement në Shqipëri lidhur me një kërkesë, për të organizuar dhe vënë në veprim *programin "Shoqëritë e nxënësve"*, në përputhje me politikat zyrtare të organizatës Junior Achievement dhe në përputhje me përcaktimet e mëposhtme.

Nenet

Neni I. Anëtarësimi: Anëtarët duhet të zotërojnë të paktën një aksion. Çdo anëtar, i cili mungon në tre mbledhje të njëpasnjëshme do të përjashtohet. Anëtarët mund të përjashtohen me arsye edhe me dy të tretat e votave të bordit. Një anëtar mund të rikthehet me rekomandim të presidentit dhe me shumicë votash të bordit.

Neni II. Aksionarët: Shoqëria zotërohet nga aksionarët. Një aksionar nuk mund të zotërojë më shumë se dy aksione dhe një familje nuk mund të ketë më shumë se tre aksione në shoqëri. Mbledhjet e aksionarëve thirren nga *bordi i drejtorëve*.

Neni III. Bordi i drejtorëve: Kontrolli i shoqërisë është i *bordit të drejtorëve*, i cili përbëhet nga anëtarë të shoqërisë. Një kuorum do të përbëhet nga gjysma e bordit. Një shumicë do të vendosë për çdo pyetje.

Neni IV. Menaxhimi: Një ekip menaxhimi i përbërë nga presidenti dhe drejtuesi i çdo departamenti do të zbatojë direktivat e bordit.

Neni V. Kompensimi: Paga minimale do të jetë 50 lekë për orë. Paga minimale për drejtuesit e zgjedhur do të jetë 200 lekë për çdo mbledhje ose 2 200 leke pagë vjetore për 12 javët e kohëzgjatjes në shoqëri. Asnjë anëtar i shoqërisë nuk do të paguhet për mbledhjen e parë. Një komision prej të paktën 10% do të paguhet për shitjet.

Neni VI. Financa: Çequet duhet të nënshkruhen nga një drejtues dhe të kundërfirmosen nga vullnetari.

Neni VII. Veprimtaria: Shoqëria do të kufizojë veprimtarinë e saj brenda territorit të zyrës vendore të JA dhe do ta përfundojë atë brenda afatit të përcaktuar kohor.

Neni VIII. Produktet dhe veprimtaritë: Produktet dhe veprimtaritë duhet të miratohen nga *zyra e Junior Achievement në Shqipëri*. Ato do të kenë vlerë të shtuar nga punonjësit e shoqërisë. Prodhimi, montimi dhe përdorimi i produkteve ose i shërbimeve të shoqërisë nuk do të paraqesin rrezik për konsumatorët apo për punonjësit.

Neni IX. Amendime: Këto nene mund të ndryshohen me dy të tretat e votave të *bordit të drejtorëve* dhe me miratimin e zyrës së Junior Achievement në Shqipëri.

Si një shoqëri Junior Achievement, Ne Aka pranon aktet rregulluese të lartpërmendura.

Letër për aksionerin

I dashur Aksionar:

“Ne Aka”, si një biznes social, ka zhvilluar aktivitetin e saj me qëllimin për të promovuar përfshirjen dhe barazinë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nëpërmjet veprimtarisë sonë, kemi krijuar një hapësirë ku këta fëmijë mund të shprehin talentin dhe kreativitetin e tyre, duke u bërë pjesë aktive e shoqërisë.

Kemi kënaqësinë t’ju raportojmë se gjatë kësaj periudhe kemi arritur të ndërtojmë dhe zhvillojmë një platformë virtuale ku prezantohen dhe shiten produkte unike të realizuara nga fëmijët. Përveç kësaj, kemi organizuar aktivitete artistike dhe krijuese që kanë ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre kreativ, emocional dhe social.

Të ardhurat e kompanisë janë siguruar kryesisht nga shitja e produkteve dhe bashkëpunimet me organizata dhe biznese që mbështesin kauza sociale. Në të njëjtën kohë, një pjesë e fondeve është përdorur për të mbështetur aktivitetet tona, për organizimin e eventeve artistike dhe për zhvillimin e vazhdueshëm të platformës sonë.

Si çdo biznes, kemi pasur edhe shpenzime që lidhen me materialet, organizimin e aktiviteteve, mirëmbajtjen e platformës dhe mbështetjen e fëmijëve në procesin krijues. Megjithatë, qëllimi ynë kryesor nuk ka qenë maksimizimi i fitimit, por krijimi i ndikimit social dhe mbështetja e drejtpërdrejtë e përfituesve tanë.

Si rezultat, fitimi i realizuar nga aktiviteti i kompanisë është përdorur për qëllime sociale dhe është shpërndarë në formën e mbështetjes dhe donacioneve për iniciativa dhe organizata partnere që punojnë në të njëjtin drejtim. Kjo qasje përforcon misionin tonë për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Gjatë këtij rrugëtimi kemi hasur sfida të ndryshme, por kemi fituar përvojë të vlefshme në menaxhimin e një biznesi social dhe në ndërtimin e një modeli të qëndrueshëm. Kemi mësuar rëndësinë e bashkëpunimit, përkushtimit dhe besimit në arritjen e objektivave tona.

Në të ardhmen, synojmë të zgjerojmë aktivitetin tonë duke zhvilluar më tej platformën, duke organizuar më shumë punëtori dhe programe artistike, si dhe duke rritur ndikimin tonë në komunitet. Vizioni ynë është që “Ne Aka” të bëhet një model frymëzues në Shqipëri dhe më gjerë, duke fuqizuar fëmijët dhe duke promovuar barazinë dhe diversitetin.

Në përfundim, dëshirojmë t’ju falënderojmë sinqerisht ju, aksionarët tanë, për mbështetjen dhe besimin tuaj. Pa kontributin tuaj, kjo iniciativë nuk do të ishte e mundur.

Sinqerisht,

Erda Çaushi
Presidente, “Ne Aka”

Letër për vullnetarin

E nderuar znj. Edlira Mali,

Në emër të të gjithë ekipit tonë, dëshirojmë t'ju shprehim mirënjohjen dhe falënderimet tona më të sinqerta për mbështetjen, përkushtimin dhe udhëheqjen tuaj gjatë zhvillimit të këtij moduli.

Gjatë gjithë këtij rrugëtimi, roli juaj si mentore ka qenë thelbësor për ne. Ju nuk na keni ofruar vetëm njohuri teorike, por mbi të gjitha keni ndarë me ne eksperiencën tuaj të vyer në fushën e marketingut, duke na ndihmuar të kuptojmë më qartë se si funksionon një biznes në praktikë. Falë jush, kemi arritur të zhvillojmë aftësi të rëndësishme si puna në grup, mendimi kritik, komunikimi dhe qasja strategjike ndaj ideve tona.

Eksperienca juaj si pedagoge në Western Balkans University ka reflektuar në çdo këshillë dhe udhëzim që na keni dhënë. Qartësia në shpjegime, profesionalizmi dhe përkushtimi juaj kanë qenë një frymëzim i vazhdueshëm për ne, duke na motivuar të japim më të mirën tonë në çdo fazë të këtij projekti.

Gjithashtu, vlerësojmë shumë gatishmërinë tuaj për të qenë gjithmonë pranë nesh, për të dëgjuar idetë tona dhe për të na orientuar në momentet kur kemi pasur nevojë për mbështetje. Këshillat tuaja praktike dhe inkurajimi i vazhdueshëm kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e punës sonë dhe në arritjet që kemi realizuar si ekip.

Ky eksperiencë nuk do të kishte qenë e njëjtë pa kontributin tuaj të çmuar. Për këtë arsye, ju jemi thellësisht mirënjohës për gjithçka që keni bërë për ne.

Ju falënderojmë edhe njëherë për kohën, durimin dhe përkushtimin tuaj, si dhe për frymëzimin që na keni dhënë për të vazhduar përpara me besim, pasion dhe vendosmëri.

Me respekt dhe mirënjohje të thellë,
Ekipi "Aka".